



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE  
DREJTORIA MINERARE

Lënda: Kërkesë për Informacion

Në përgjigje të email tuaj, datë 01.08.2023, me lëndë “Kërkesë për Informacion”, mbi shqetësimin e banorëve të tre fshatrave në Bashkinë e Bulqizës, konkretisht (Vajkal 1, Vajkal 2 dhe Dragu), ju sqarojmë si më poshtë:

1. AKBN ka informacion për licensë aktive shfrytëzimi në sektorin minerar, në zonën që banorët kanë protestuar dhe i referohen në daljet publike?

**Përgjigje:**

Në afërsi të depos së ujit në lagjen e re, Bulqizë (Vajkal 2), nga ku ka filluar rruga e cila po avancon në drejtim të pyjeve pranë liqeneve të Balgjait, nuk ka leje minerare shfrytëzimi. Në këtë zonë operojnë edhe leje të kërkim-zbulimit të cilat nga institucioni i AKBN, nuk janë objekt kontrolli, ato janë nën juridiksionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

2. Nëse po, AKBN ka kryer inspektime lidhur me respektimin e licensës minerare? Më vendosni në dispozicion lejen përkatëse minerare, objektin e veprimtarisë dhe procesverbalet e inspektimeve të kryera në zonën përkatëse.

**Përgjigje:**

Nuk ka patur kontroll nga AKBN, sepse nuk ka leje minerare shfrytëzimi.

3. Ka pasur më parë referim nga institucionet vendore në qarkun Dibër për shkelje të konstatura? Këtu duke përfshirë si strukturat e Policisë, Bashkia Bulqizë apo institucione të tjera ligjzbatuese.

**Përgjigje:**

Nuk ka patur asnjë referim nga institucionet e cituara më sipër.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Drejtoria Minerare